

VENDIM
Nr. 537, datë 29.7.2022

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 35, DATË 19.1.2022,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PUNONJËSIT ME KONTRATË TË
PËRKOHSHE, PËR VITIN 2022, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 12, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen nr. 1, që përmendet në pikën 1, të vendimit nr. 35, datë 19.1.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në ndarjet “Gr.02, Kuvendi”, “Gr.05, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”, “Gr.10, Ministria e Financave dhe Ekonomisë”, “Gr.14, Ministria e Drejtësisë”, “Gr.16, Ministria e Brendshme”, dhe “Gr.41, Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, shtohen nëndarjet përkatëse, sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) Periudha kohore me 6 (gjashtë) orë në ditë e 11 (njëmbëdhjetë) punonjësve në shtëpitë e pushimit, në ndarjen “Gr.16, Shërbimi Informativ Shtetëror”, bëhet 8 (tetë) orë në ditë.

2. Ngarkohen Kuvendi, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Shërbimi Informativ Shtetëror dhe Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të depozitojnë, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, detajimin e numrit të punonjësve me kontratë, periudhën kohore të punësimit dhe kategorinë përkatëse të pagës së tyre.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Tabela nr. 1

Gr.	Emri i institucionit	Nr. i punonjësve 2022	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
02	Kuvendi	1			
	Shërbimi i transportit	1	Specialist	8 orë/ditë	6 muaj
05	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	14			
	Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Korçë	6	Punonjës mirëmbajtjeje/skare	6 orë/ditë	vjetore
	Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Tiranë, Lushnjë, Korçë e Shkodër	4	Specialist	8 orë/ditë	6 muaj
	Aparati i MBZHR-së	4	Specialist	8 orë/ditë	6 muaj
10	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	7			
	Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut	7	Specialist	8 orë/ditë	6 muaj
14	Ministria e Drejtësisë	1			
	Instituti i Mjekësisë Ligjore	1	Specialist arkiv-protokolli	8 orë/ditë	6 muaj
16	Ministria e Brendshme	2			
	Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit	2	Specialist arkiv-protokolli	8 orë/ditë	6 muaj

41	Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar	6			
	Prokuroria e Posaçme	4	Specialist i sekretarisë administrative	8 orë/ditë	6 muaj
	Prokuroria e Posaçme	2	Punonjës mirëmbajtjeje	8 orë/ditë	6 muaj
	TOTAL PUNONJËS ME KONTRATË	31			